




AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS
AGENCIJA ZA STATISTIKE KOSOVA
KOSOVO AGENCY OF STATISTICS



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria e Kosovës - Vlada Kosova - Government of Kosova
Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera
Office of the Prime Minister

VLERËSIM

Popullsia e Kosovës 2011



VLERËSIM

Popullsia e Kosovës 2011

Parathënie

Vlerësimi i numrit të popullsisë është domosdoshmëri, praktikë dhe standard, që kërkohet të bëhet çdo vit nga institucionet zyrtare të statistikave të një vendi.

Kjo për faktin se në periudhën ndërmjet dy regjistrimeve (dhjetëvjeçare) ndodhin ndryshime të theksuara në popullsinë e një vendi, komune a vendbanimi.

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) çdo vit ka bërë vlerësimin e numrit të popullsisë në nivel vendi. Më pas, këtë shifër e ka përdorur si indikator themelor për analiza dhe planifikime të tjera.

Të dhënat vjetore statistikore mbi popullsinë (demografinë) janë themelore për studimin dhe përcaktimin e një game të gjerë analizash. Sidomos lidhja dhe rëndësia e veçantë e tyre me çështjet sociale dhe ekonomike në nivele të caktuara komunale, kombëtare dhe rajonale.

Statistikat mbi popullsinë janë një emërues dhe tregues i rëndësishëm i vendimmarrëseve, analistëve, hulumtuesve dhe shfrytëzuesve të ndryshëm të të dhënave.

Të dhënat mbi popullsinë përbëjnë komponentin thelbësor për vlerësimet e llogarive kombëtare, punësimit dhe çështjeve të tjera socio-ekonomike.

Prandaj, për të gjithë shfrytëzuesit e të dhënave, këto janë të dhënat e fundit zyrtare, të vlerësuara për numrin e popullsisë së Kosovës në nivel të komunave për vitin 2011. Vlerësimi i ardhshëm (për vitin 2012) do të bëhet nga mesi i vitit 2013.



Kryeshefi i Agjencisë së Statistikave të Kosovës

Z. Isa Krasniqi

Përmbajtja

PARATHËNIE	4
HYRJE	6
Regjistrimi i Popullsisë i vitit 2011	12
Azhurnimi 2009.....	12
Periudha kohore	12
Mbulueshmëria.....	12
KAPITULLI 1	12
Qëllimi i projektit	13
Metodologjia e grumbullimit të të dhënave	13
Kualiteti i të dhënave nga azhurnimi 2009	14
Popullsia	14
Ekonomitë familjare	15
Konkluzionet	16
Vlerësimi për komunat: Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe pjesën veriore të Mitrovicës.....	18
Ekonomitë familjare	18
KAPITULLI 2	18
Popullsia	20
Kualiteti i të dhënave.....	20
Krahasimi i të dhënave	21
Të dhënat demografike	23
Të dhënat nga regjistrimet e popullsisë 1948-1991.....	24
Zhvendosjet e popullsisë	25
Lëvizjet e popullsisë 01 prill - 31 dhjetor 2011	28
Shtimi natyror.....	28
Kualiteti i të dhënave.....	28
KAPITULLI 3	28
Lëvizjet e tjera të popullsisë (migrimet)	31
Emigrimi dhe imigrimi	31
Emigrimi dhe imigrimi i brendshëm	32
Emigrimi dhe imigrimi i jashtëm	34
Emigrimi i jashtëm.....	34
Imigrimi i jashtëm	35

HYRJE

Për shfrytëzuesit e të dhënave

Deri në regjistrimin e parafundit zyrtar, atë të vitit 1981, popullsia që punonte dhe jetonte për një kohë jashtë Kosovës, e quajtur si "Popullsia që përkohësisht gjendej jashtë vendit" është llogaritur si popullsi e vendit përkatës. Pra, vlerësimet e mëhershme për numrin e popullsisë përfshinin edhe popullsinë jo-rezidente (deri në vitin 2011).

Pas miratimit të legjislacionit themelor statistikor (dy ligjeve): Ligjit për Regjistrimin e Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave (Ligji Nr. 03/L-237) dhe Ligjit për Statistikat Zyrtare të Republikës së Kosovës (Ligji Nr. 04/L-036), të miratuara gjatë vitit 2010-2011, si dhe pas ndryshimeve të definicionit mbi popullsinë rezidente të një vendi¹ dhe rekomandimeve të UNSD² dhe EUROSTAT-it³, krahasuar me regjistrimet e mëhershme: 1948, 1953, 1961, 1971 dhe 1981, në këtë raport ASK-ja ka bërë vlerësimin e popullsisë rezidente duke respektuar ligjet në fuqi.

Edhe pse Kosova nuk është pjesë e Bashkimit Evropian (BE), ashtu sikurse shtetet kandidate dhe kandidate potenciale, edhe Kosova çdo vit i transmeton (dërgon) të dhënat demografike në EUROSTAT, duke respektuar kriteret e përcaktuara, si dhe afatet kohore. Sipas Propozim Rregullores së Parlamentit Evropian⁴ (*Regulation of the European Parliament and of the Council on European statistics on demography*) nenit 4, të gjitha shtetet duhet t'i dërgojnë të dhënat në EUROSTAT brenda 8 muajve, pas vitit kalendarik. Po ashtu, sipas nenit 5, si datë referuese duhet të jetë mesnata e 31 dhjetorit të vitit kalendarik.

Pasi që ky është vlerësimi i parë mbi numrin e popullsisë që bëhet në nivel të komunave, në pjesën e mëposhtme është dhënë sqarimi për shfrytëzuesit e të dhënave mbi: metodologjinë, kualitetin e të dhënave, harmonizimin, korrigjimin e mospërputhjeve, cilësinë dhe qartësinë e redaktimit, si dhe është bërë dokumentimi i variablave të imputimit⁵.

Po ashtu, në këtë raport është shpjeguar koherenca⁶ e të dhënave, ku për qartësi të shfrytëzuesve, janë përdorur elaborime shtesë, si dhe tabela të veçanta, për t'i arritur të dhënat përfundimtare (tabelat finale).

Relevanca e këtyre të dhënave, në të ardhmen do të përditësohet me të dhënat e disponueshme, si dhe saktësinë e atyre të dhënave.

¹ Ndryshimet dhe harmonizimi i standardeve mbi definicionet kryesore të rekomanduara për regjistrime është bërë nga vitet e '90-ta e sidomos nga viti 2000.

² Divizioni i Kombeve të Bashkuara për statistikë

³ Zyra statistikore e Bashkimit Evropian

⁴ Regulation of the European Parliament and of the Council on European statistics on demography

⁵ Metode statistikore që nënkupton plotësimin e të dhënave. Këto janë vlera të mundshme bazuar në informacione të tjera në dispozicion

⁶ I referohet përshtatshmërisë së të dhënave të kombinuara të besueshme në mënyra të ndryshme dhe për përdorime të ndryshme

Periudha referuese

Vlerësimi i popullsisë së Kosovës për vitin 2011, si bazë i referohet Regjistrimit të fundit të Popullsisë, që është realizuar në muajin prill 2011, si dhe ndryshimeve demografike e lëvizjeve të tjera, që kanë ndodhur pas Regjistrimit të Popullsisë deri më 31 dhjetor 2011.

Baza mbi vlerësimin e popullsisë

Në përgatitjen e këtij Vlerësimi, ASK-ja ka aplikuar metodat e praktikuara mbi vlerësimin e popullsisë, që bëhen nga institucionet statistikore, çdo vit, duke shfrytëzuar burimet e ndryshme.

Bazuar në Ligjin për Statistikat Zyrtare të Republikës së Kosovës (Ligji Nr. 04/L-036) neni 29, pika 2: ASK-ja ka të drejtë të bëjë përshtatjen e të dhënave të fituara nga burimet administrative, në mënyrë që ato të harmonizojë me përkufizimet dhe klasifikimet, që përdoren për regjistrat statistikore, të cilët i mban.

Po ashtu, sipas Propozim Rregullores së Parlamentit Evropian për Statistika dhe Demografi (*Regulation of the European Parliament and of the Council on European statistics on demography*) neni 7: të dhënat për vlerësime duhet të bazohen në burimet e të dhënave të zgjedhura nga shtetet, që janë në përputhje me ligjet dhe praktikat kombëtare. Vlerësimi i bazuar shkencërisht dhe i dokumentuar me metoda statistikore përdoret kur është e përshtatshme.

Vështrimi metodologjik

Si bazë e të dhënave (pikënisje) është marrë Regjistrimi i Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave 2011.

Për komunat që nuk ishin pjesë e Regjistrimit të Popullsisë (2011), ASK-ja ka bërë vlerësimin e numrit të popullsisë, bazuar në burimet e ndryshme, e që në tekstin e mëposhtëm janë dhënë sqarime të detajuara me qëllim që shfrytëzuesit t'i vlerësojnë këto burime.

Për komunat: Leposaviq, Zveçan, Zubin Potok, si dhe në pjesën veriore të Mitrovicës, si bazë kryesore për vlerësim është marrë "Azhurnimi 2008-2009"⁷.

Për ta vlerësuar numrin e popullsisë në nivel kombëtar, popullsia rezidente është e ndikuar nga nataliteti, mortaliteti dhe migrimi ndërkombëtar (NMMN).

Vlerësimi i popullsisë = popullsia bazë + nataliteti – mortaliteti ± migrimi ndërkombëtar.

⁷ Në tekstin e mëposhtëm do të përdoret termi i shkurtuar: Azhurnimi 2009

HYRJE

Në nivel komune, popullsia rezidente është e ndikuar edhe nga një komponent shtesë i ndryshimit të popullsisë: migrimit të brendshëm (NMMB).

Vlerësimi i popullsisë = popullsia bazë + nataliteti – mortaliteti ± migrimi i jashtëm/ brendshëm.

Të dhënat e **vlerësuara përfundimtare** mbi numrin e popullsisë në nivel të komunave janë llogaritur sipas procedurave të mëposhtme:

$$P_n = P_0 + (N - M) + (I - E)$$

P_n - numri i banorëve të përlogaritur për vitin e dhënë

P₀ - Popullsia e vitit të regjistruar, P0-31 mars 2011

N - numri i lindjeve të gjalla (Nataliteti), 01 prill-31 dhjetor 2011

M - numri i vdekjeve (Mortaliteti), 01 prill-31 dhjetor 2011

I - imigrimet, 01 prill-31 dhjetor 2011

E - emigrimet, 01 prill-31 dhjetor 2011

Burimet e të dhënave


Për ta vlerësuar numrin e popullsisë janë shfrytëzuar burime të ndryshme statistikore, si: bazat nga regjistrimet e popullsisë, bazat nga azhurnimet, bazat e shënimeve nga regjistrat e ndryshëm, burimet e tjera administrative, anketat, raportet dhe hulumtimet e tjera.

Këto të dhëna janë analizuar sipas metodave statistikore, duke shërbyer si instrumente dhe shënime të rëndësishme statistikore për ta bërë vlerësimin e numrit të popullsisë në nivel vendi dhe në nivel të komunave.

Si baza reference në këtë Vlerësim janë shfrytëzuar këto burime:

- Të dhënat nga Regjistrimi i Popullsisë: burimi i informacionit, regjistrimi 2011, ASK
- Të dhënat nga azhurnimi 2009: burimi i informacionit nga ASK-ja (2008-2009).
- Të dhënat nga vlerësimi i popullsisë 1991: burimi i informacionit, vlerësimet nga EFJ
- Të dhënat nga regjistrimi i popullsisë: burimi i informacionit, regjistrimet viti 1948-2011
- Të dhënat nga anketat: iu referohen hulumtimeve nga ASK-ja dhe institucioneve të tjera
- Të dhënat nga DSP: iu referohen të dhënave vitale nga Departamenti i statistikave të popullsisë në ASK.
- Të dhënat nga DSS: iu referohen të dhënave nga anketat e Departamentit të statistikave sociale në ASK.
- Të dhënat nga Ministritë: burimi i informacionit, bazave të shënimeve të ministrive përkatëse
- Regjistrat administrative: burimi i informacionit, regjistrat e institucioneve përkatëse
- Të dhënat nga komunat: burimi i informacionit, ueb faqet dhe dokumenteve të tjera zyrtare të komunave
- Të dhënat nga OSBE: burimi i informacionit iu referohen të dhënave nga komunat përkatëse
- Të dhënat nga UNHCR: iu referohen të dhënave të fundit nga baza e statistikave nga kjo organizatë
- Qendra Evropiane për Çështje të Minoriteteve, Zyra Rajonale në Kosovë⁸: burimi, të dhënat nga komunat përkatëse.
- Të dhënat nga Serbia: burimi i informacionit, faqja zyrtare e Statistikave <http://webrzs.stat.gov.rs/WebSite/>
- Të dhënat e tjera: iu referohen publikimeve të ndryshme të organizatave, institucioneve apo grupeve të caktuara

⁸ European Centre for Minority Issues Regional Office – ECMI Kosovo



KAPITULLI 1

Regjistrimi i Popullsisë i vitit 2011

Regjistrimi i popullsisë, i realizuar në muajin prill 2011, është bërë në harmoni me standardet dhe rekomandimet ndërkombëtare të UNSD⁹, si dhe rekomandimeve të EUROSTAT-it¹⁰ për regjistrime. Sipas institucioneve vendore dhe ndërkombëtare procesi është vlerësuar pozitivisht dhe të dhënat janë përfundimtare zyrtare.

Procesi i Regjistrimit të Popullsisë, pothuajse gjatë të gjitha fazave deri në publikimin e rezultateve përfundimtare është asistuar dhe monitoruar nga institucionet ndërkombëtare mbi statistikat. ASK ka bërë publike edhe informacionet shtesë për shfrytëzuesit, lidhur me ecurinë dhe kualitetin e këtyre të dhënave të përmbledhura në dy raporte speciale: Raporti i kualitetit të të dhënave, si dhe Raporti mbi anketimin pas regjistrimit.

Sipas të dhënave nga Regjistrimi i Popullsisë i realizuar në prill të vitit 2011, Kosova kishte gjithsej 1.739.825 banorë rezidentë, pa përfshirë komunat: Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut.

Azhurnimi 2009

Në analizat dhe trendët demografikë, të dhënat e nxjerra nga Azhurnimi 2009 rezultuan të jenë në harmoni me të dhënat e dala nga Regjistrimi i Popullsisë 2011. Andaj, të dhënat për komunat, të cilat nuk kishin marrë pjesë në Regjistrimin e Popullsisë (prill 2011), si burim kryesor për vlerësimin e numrit të popullsisë, ekonomive familjare dhe të disa indikatorëve të tjerë *deri në të dhënat e tjera më të freskëta* janë marrë të dhënat nga azhurnimi i vitit 2009.

Periudha kohore

Në kuadër të përgatitjeve për regjistrimin e përgjithshëm të popullsisë si dhe aktiviteteve të tjera, në fund të vitit 2008 ASK-ja kishte bërë azhurnimin e rreth 1.000 Qarqeve Regjistruese (QR) nga gjithsej rreth 4.650. Në fund të vitit 2009, me qëllim të përgatitjeve të duhura dhe për nevoja të tjera për Regjistrimin e Popullsisë ASK-ja kishte bërë azhurnimin e Qarqeve të tjera të mbetura.

Mbulueshmëria

Projekti i azhurnimit 2009 është realizuar në tërë territorin e Kosovës. Nuk ka pasur asnjë refuzim, duke përfshirë edhe nivelin më të vogël, siç ishte Qarku Regjistruer (QR). Te gjitha komunat dhe komunitetet që jetojnë në Kosovë ishin përfshirë në këtë projekt.

⁹ Divizioni i Kombeve të Bashkuar për statistikë

¹⁰ Zyra statistikor e Bashkimit Evropian

Qëllimi i projektit

Rëndësia e këtij projekti ishte qenësore për një regjistrim të suksesshëm, duke u bazuar në mungesën e madhe të të dhënave statistikore nga institucionet dhe komunat përkatëse, për një kohë të gjati, pasi që regjistrimi i fundit zyrtar ishte bërë në vitin 1981. Po ashtu, ishin të nevojshme ndryshime të mëdha demografike, si dhe lëvizjet e shumta të popullsisë, që u bënë pas vitit 1999, si brenda ashtu edhe jashtë Kosovës. Dhe, pothuajse ishte e pamundur të organizohet një regjistrim i suksesshëm pa një bazë solide për disa indikatorë.

Azhurnimi 2009 mundësoi që të nxirren të dhënat e përafërta për: numrin e ekonomive familjare dhe personave dhe etnicitetin, e që më pas, këto të dhëna u përdorën si bazë për:

- ndarjen e Qarqeve Regjistruese (QR),
- angazhimin e numrit të regjistrueseve në nivel të një vendbanimi dhe komune,
- numrin e kontrollorëve,
- numrin e mbikëqyrësve,
- numrin e trajnuesve,
- caktimin-sasinë e materialeve të regjistrimit në nivele të QR-së, vendbanimit dhe komunave, si: formularët, udhëzuesit, hartat etj.,
- mënyrën e organizimit dhe shpërndarjes së fushatës sensibilizuese, si dhe
- ndarjen e qendrave të trajnimeve sipas gjuhës së komuniteteve.

Njëkohësisht, ky azhurnim kishte për qëllim që gjatë procesit të Regjistrimit të përgjithshëm të Popullsisë të ishte një instrument i fuqishëm për t'i monitoruar ndryshimet e mundshme, që mund të paraqiteshin në ndonjë zonë të caktuar (pjesëmarrje-mospjesëmarrje në regjistrimin e përgjithshëm).

Kështu që, ASK-ja në fund të viti 2009, kishte një bazë solide dhe ishte përgatitur me kohë për sfidat e mundshme, që mund të paraqiteshin gjatë procesit të regjistrimit.

Organizimi dhe angazhimi i personelit në këtë projekt ishte i njëjtë sikurse skema që është përdorur gjatë Regjistrimit të Popullsisë në vitin 2011.

Metodologjia e grumbullimit të të dhënave

Grumbullimi i të dhënave nga azhurnimi 2009 ishte bërë duke i vizituar ekonomitë familjare derë me derë dhe të dhënat janë marrë përmes pyetësorëve dhe udhëzimeve të përpiluara nga ASK-ja. Në rastet kur një ekonomi familjare nuk ishte kontaktuar drejtpërdrejt, të dhënat janë marrë nga të afërmit e tjerë.

KAPITULLI 1

Gjatë regjistrimit janë përdorur hartat e përditësuara në formate, që janë përdorur më pas gjatë Regjistrimit të përgjithshëm, si dhe udhëzuesit. Po ashtu, në këta formularë është regjistruar (numëruar) vetëm popullsia rezidente.

Projekti i azhurnimit 2009 është realizuar nga operatori ekonomik (kishte konsulentë edhe nga vendet e tjera jashtë Kosovës). Ndërsa, mbikëqyrësit dhe trajnuesit kryesorë ishin nga ASK-ja. Regjistruesit dhe kontrollorët ishin përzgjedhur nga ato vendbanime, si dhe nga komunitet që jetonin në ato zona. Të dhënat janë kontrolluar, janë futur në bazën e të dhënave dhe janë analizuar gjatë periudhës 2009, ku edhe janë nxjerrë të dhënat e nevojshme, që janë përdorur për nevojat e ASK-së, komunave si dhe organizatave ndërkombëtare, që kanë monitoruar procesin e Regjistrimit të Popullsisë.

Kualiteti i të dhënave nga azhurnimi 2009

Popullsia

Të dhënat nga "Azhurnim 2009" nëse i krahasojmë me të dhënat përfundimtare, të dalta nga Regjistrimi i përgjithshëm i Popullsisë 2011, shohim një përputhshmëri shumë të afërt në aspektin statistikor të indikatorëve të përbashkët. Në disa raste (të dhënat në nivel të komunave) ishin aq të afërta sa vështirë është të dallohen, duke marrë për bazë periudhën e ndryshme kohore (datën referuese) kur ishin realizuar këto projekte.

Nga Regjistrimi i Popullsisë (2011) numri përgjithshëm i banorëve të regjistruar në Kosovë ishte 1.739.825 pa përfshirë komunat e Kosovës të theksuara më lartë, që nuk kishin marrë pjesë në regjistrim.

Nga azhurnimi 2009, numri përgjithshëm i banorëve të regjistruar në Kosovë ishte 1.766.768 pa përfshirë komunat e Kosovës të theksuara më lartë, që nuk kishin marrë pjesë në regjistrim.

Dallimi në nivel vendi ishte vetëm 1.55 % më shumë banorë të regjistruar në azhurnimin 2009.

Nëse do të merreshin në konsideratë të gjeturat nga ASK-je, që janë bërë gjatë monitorimit të procesit të azhurnimit 2009, ku ishte raportuar se në disa zona kishte pasur mbi-regjistrim prej 1-2%, atëherë të dhënat korrespondojnë plotësisht njëra me tjetrën. Në aspektin statistikor, ky ndryshim është mëse i pranueshëm, duke marrë për bazë faktorin kohë.

Në pjesën më të madhe të komunave, të dhënat nga azhurnimi 2009 korrespondojnë me të dhënat nga Regjistrimi i vitit 2011 mbi indikatorët kryesorë (*ekonomive familjare, popullsisë dhe banesave*).

Në tabelën e mëposhtme, janë marrë dy komuna të mëdha dhe dy komuna të mesme (për nga numri i banorëve) për të parë ndryshimet nga të dhënat e azhurnimit 2009, si dhe Regjistrimi i Popullsisë 2011.

Në konsideratë është marrë faktori natyror i ndryshimit të numrit të popullsisë (*shtimi natyror i popullsisë*) derisa, faktorët mekanikë (*lëvizjet e popullsisë-shkuarja-ardhja*) nuk janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Tabela 1. Krahasimet e të dhënave ndërmjet: Azhurnimit 2009 dhe Regjistrimit të Popullsisë 2011

Komunat	Nr. i popullsisë sipas azhurnimit të vitit 2009	Shtimi natyror 2009-2011 ¹¹	Azhurnimi plus shtimi natyror	Regjistrimi i Popullsisë 2011	Dallimi në nr. absolut	Dallimi ndërmjet Regjistrimit dhe azhurnimit në %
Shtime	26.497	731	27.228	27.324	96	0,35
Prishtinë	186.651	4.877	191.528	198.897	7.369	3,7
Pejë	94.689	2.144	96.833	96.450	-383	-0,4
Kamenicë	32.720	595	33.315	33.409	94	0,28
Gjithsej	340.557	8.347	348.904	356.080	7.176	2,02

Rezultatet treguan se kishte një përputhshmëri të plotë të numrit të popullsisë, përveç Prishtinës. Ndryshimi i shprehur në komunën e Prishtinës, si kryeqendër e Kosovës, është edhe si rezultat i imigrimit (ardhjes) nga viset dhe komunat e tjera, e që janë vendosur në këtë komunë gjatë periudhës 2009-2011.

Azhurnimi 2009 tregoi se të dhënat mbi numrin e popullsisë ishin të përafëruara edhe me hulumtimet e ASK-së, të realizuara më parë.

Tabela 2. Numri i popullsisë sipas Anketës së fuqisë punëtore të realizuar nga DSS në ASK

Vitet	Numri i popullsisë
2001	1.876.586
2002	1.704.362
2003	1.771.410
2004	1.689.657
2005	1.734.231
2006	1.766.868

Ekonomitë familjare

Numri mesatar i anëtarëve në një ekonomi familjare, krahasuar me të dhënat e azhurnimit 2009 dhe ato të Regjistrimit të Popullsisë, i realizuar në muajin prill 2011, kishte një dallim të vogël. Derisa, në

¹¹ Për periudhën dhjetor 2009 - 31 mars 2011

KAPITULLI 1

azhurnimin e vitit 2009 të dhënat tregojnë se numri mesatar i anëtarëve të një ekonomie familjare në nivel vendi ishte rreth 6.3 banorë, sipas Regjistrimit të Popullsisë 2011, numri mesatar i një ekonomie familjare në nivel vendi ishte 5.9 banorë.

Këto ndryshime janë edhe si rezultat i ndarjes së ekonomisë familjare në njësi më të vogla familjare, brenda periudhës 2009-2011. Duke marrë për bazë kohën e realizimit në periudha të ndryshme në aspektin statistikor, këto ndryshime të numrit mesatar në një ekonomi familjare janë plotësisht të pranuar.

Konkluzionet

Bazuar në këto të dhëna të prezantuara (*azhurnimi 2009*) të cilat janë faktike e që janë shumë të përafërta me të dhënat e dala nga Regjistrimi i Popullsisë 2011, si dhe me të dhënat nga burimet e tjera, ASK-ja do t'i përdorë të dhënat nga azhurnimi 2009 si të dhëna zyrtare të vlerësuara për komunat: Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe pjesën veriore të Mitrovicës deri në përditësimin e tyre.

KAPITULLI 2

Vlerësimi për komunitet: Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe pjesën veriore të Mitrovicës

Shënim: për shkak se pjesa veriore e Mitrovicës nuk ishte zonë e ndarë administrative nga pjesa tjetër e Mitrovicës, në analizën e mëposhtme ishte e pamundur të bëheshin krahasime me burimet e mëhershme, përveç të dhënave nga azhurnimi 2009, derisa për komunitet: Leposaviq, Zveçan dhe Zubin Potok janë shfrytëzuar burimet e ndryshme të të dhënave ku është bërë krahasimi.

Ekonomitë familjare

Sipas të dhënave nga azhurnimi i vitit 2009 numri i ekonomive familjare për katër komunitet e Kosovës që u theksuan më lartë ishte gjithsej 11.122 ekonomi familjare.

Në tabelën e mëposhtme janë dhënë të dhënat sipas azhurnimit 2009 për: numrin e ekonomive familjare, mesataren e anëtarëve në një ekonomi familjare të ndara në dy grupe sipas etnicitetit¹²: 1 shqiptar dhe 2 serbë dhe të tjerë. Të dhënat janë shprehur në numra absolutë dhe relativë.

Tabela 3. Numri i ekonomive familjare sipas etnicitetit /mesatares së anëtarëve në një ekonomi familjare

Komunitet	Numri i ekonomive familjare			Përqindja (%)	
	Gjithsej	Shqiptarë	Serbë dhe të tjerë	Shqiptarë	Serbë dhe të tjerë
Leposaviq	4.193	58	4.135	0,52	37,18
	100	1,38	98,62		
Zubin Potok	1.698	154	1.544	1,38	13,88
	100	9,07	90,93		
Zveçan	1.838	40	1.798	0,36	16,17
	100	1,38	98,62		
Mitrovica e Veriut	3.393	191	3.202	1,72	28,79
	100	5,63	94,37		
Gjithsej/mesatarja	11.122	443	10.679	3,98	96,02

Sipas të dhënave nga azhurnimi 2009, shqiptarët përbënin 3.98% apo gjithsej 443 ekonomi familjare. Serbët dhe të tjerët përbënin 96.02 të ekonomive familjare apo 10.679 ekonomi familjare.

¹² Ndarja në grupe me të vogla etnike në këtë fazë mund të kishte lëshime dhe njëkohësisht këto komunitete sipas disa burimeve të të dhënave përbënin rreth 98% të popullsisë së kësaj zone.

Madhësia e një ekonomie familjare krahasuar me dy proceset kishte një dallim mesatar rreth 0.3 persona.

Tabela 4. Madhësia e ekonomive familjare sipas Azhurnimit 2009 dhe Regjistrimit të Popullsisë 2011

Etniciteti	Madhësia e ekonomive familjare		
	Azhurnimi 2009	Regjistrimi i Popullsisë 2011	Dallimi
Shqiptarë	6,3	5,9	-0,4
Serbë	3,5	3,7	0,2

Në tabelën e mëposhtme janë dhënë dy burimet e të dhënave për mesataren e numrit të anëtarëve në një ekonomi familjare në disa komuna të Kosovës vetëm për komunitetin serb.

Tabela 5. Numri mesatar i anëtarëve në një ekonomi familjare serbe: azhurnimi 2009/Regjistrimi 2011

Komunat	Azhurnimi 2009	Regjistrimi i Popullsisë 2011
Graçanicë	4,1	4,3
Ranillug	4,1	4,2
Partesh	4,3	4,3
Klllokot	4,1	4,1
Kamenicë	3,5	3,8
Fushë Kosovë	3,5	3,9
Obiliq	3,9	4,2
Novobërdë	4,1	3,8
Vushtrri	4,7	4,2

Përkundër se këto dy aktivitete janë realizuar ndaras, dhe në kohë të ndryshme, nga të dhënat e prezantuara, shihet se ka përaftrim të shprehur statistikor mes dy burimeve.

Pasi që të dhënat nga azhurnimi 2009 janë në harmoni rreth mesatares së anëtarëve në një ekonomi familjare serbe me të dhënat e dala nga Regjistrimi i Popullsisë 2011, këto të dhëna do të merren zyrtare për këtë zonë të Kosovës.

KAPITULLI 2

Popullsia

Siç dihet, komunat e theksuara nuk morën pjesë në Regjistrimin e Popullsisë të realizuar në muajin prill 2011, andaj, të dhënat e nxjerra nga burimet e ndryshme, që janë shfrytëzuar në këtë raport mbi numrin e popullsisë për këtë zonë, janë ***vlerësim***.

Sipas të dhënave nga azhurnimi i vitit 2009 numri i popullsisë për këto komuna të Kosovës, që u theksuan më lartë, ishte gjithsej 40,196 banorë.

Tabela 6. Numri i popullsisë sipas përbërjes etnike nga azhurnimi 2009

Komunat	Popullsia			Pjesëmarrja e popullsisë sipas etnicitetit	
	Gjithsej	Shqiptarë	Serbë dhe të tjerë	Shqiptarë	Serbë dhe të tjerë
Leposaviq	13.773	323	13.450	0,8	33,46
	100	2,35	97,65		
Z.Potok	6.616	995	5.621	2,48	13,98
	100	15,04	84,96		
Zveçan	7.481	386	7.095	0,96	17,65
	100	5,16	94,84		
Pjesa v. e Mitrovicës	12.326	867	11.459	2,16	28,51
	100	7,03	92,97		
Gjithsej/mesatarja	40.196	2.571	37.625	6,4	93,6

Përbërja etnike e ndarë në dy grupe ishte si më poshtë: Popullsia shqiptare në këto tri komuna përbënte 6.40% apo 2,571 banorë, ndërsa ajo serbe dhe të tjerët rreth 93.60% apo 37,625 banorë.

Kualiteti i të dhënave

Përkundër burimeve të ndryshme është për t'u evidentuar se pothuaj të gjitha të dhënat për numrin e popullsisë, të komunitetit shqiptar (*Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan, pa pjesën veriore të Mitrovicës*) ishin të njëjta me ato të azhurnimit 2009, kur merret parasysh koha e ndryshme e nxjerrjes së këtyre të dhënave.

Sipas të dhënave nga azhurnimi 2009 numri i përgjithshëm i popullsisë shqiptare në këto tri komuna ishte gjithsej 1,704 banorë, derisa, sipas komunave përkatëse dhe OSBE¹³-së ishin gjithsej 1,700 banorë. Dallimi ishte vetëm për 4 banorë, dhe kur kësaj i shtohet faktori kohë, themi se të dhënat paraqesin numër të njëjtë të popullsisë shqiptare në këtë zonë. Në burimet e OSBE-së, nuk ka të dhëna absolute për pjesën veriore të Mitrovicës. Ndërsa, të dhënat relative për këtë pjesë, po ashtu ishin shumë të përafërta me ato të azhurnimit 2009.

Tabela 7. Të dhënat mbi numrin e popullsisë shqiptare sipas burimeve

Komunat	Azhurnimi 2009	Komuna përkatëse dhe OSBE ¹⁴
	Shqiptarë	
Leposaviq	323	350
Zubin Potok	995	1.000
Zveçan	386	350
Mitrovica e Veriut	7,03%	7,10%

Pasi që të dhënat e dala nga azhurnimi 2009 për komunitetin shqiptar janë të dhëna reprezentative, ato do të jenë të dhëna zyrtare për këtë pjesë të Kosovës.

Të dhënat për komunitetin serb, të nxjerra nga burimet e ndryshme, tregojnë se numri i popullsisë serbe kishte një dallim të shprehur, krahasuar me të dhënat e nxjerra nga azhurnimi i vitit 2009.

Vlen të theksohet se ndonëse si burim kryesor ishin komunat përkatëse (zyrtarët komunalë) të dhënat e prezantuara nga institucionet e ndryshme, duke përfshirë ato ndërkombëtare, kishin dallime të theksuara në numrin e popullsisë së komunitetit serb në këto komuna, edhe pse si vit referues kishin vitin e njëjtë.

Krahasimi i të dhënave

Në tabelën e mëposhtme janë dhënë të dhënat nga: azhurnimi 2009, komuna e Leposaviqit, Zveçanit si dhe të dhënat nga OSBE-ja. Siç u cek më lart, si burim i të dhënave për OSBE-në dhe për shumë organizata të tjera ndërkombëtare ishin administratat komunale të këtyre komunave.

¹⁴ MUNICIPAL PROFILES November 2011, OSBE, Mission in Kosovo – Burim i bazuar në administratat komunale të këtyre komunave

KAPITULLI 2

Tabela 8. Krahasimi i të dhënave sipas burimeve

Komunat	Vlerësimi i popullsisë, ¹⁵ 1991	Komuna: Leposaviq, Zveçan ¹⁶ , 2010	Azhurnimi 2009	OSBE ¹⁷ 2010	Azhurnimi 2009	OSBE	Azhurnimi 2009	OSBE
	Gjithsej				Shqiptar		Serb dhe t tjerë	
Leposaviq	16.395	14.262	13.773	18.890	323	350	13.450	18.540
Z.Potok	8.479	—	6.616	14.900	995	1.000	5.621	13.900
Zveçan	10.030	17.000	7.481	16.650	386	350	7.095	16.300
Mitrovicë V.	—	—	12.326	29.460	867	4.900	11.459	24.560
Gjithsej	34.904	31.262	40.196	79.900	2.571	6.600	37.625	73.300

Të dhënat nga ueb faqja zyrtare e komunës së Leposaviqit janë të afërta me të dhënat nga azhurnimi 2009. Të dhënat nga ueb faqja zyrtare e komunës së Zveçanit nuk përkojnë me të dhënat e azhurnimit 2009. Të dhënat për komunën e Zveçanit nuk i kemi hasur në dokumentet zyrtare/ueb faqe të kësaj komune.

Po ashtu, sipas Qendrës Evropiane për Çështje të Minoriteteve, Zyra Rajonale në Kosovë (*European Centre for Minority Issues Regional Office – ECMI Kosovo*) e që si burim të të dhënave të vlerësuara kanë zyrat lokale të komuniteteve, të krahasuara për kontroll me Profilët e Komunave, të nxjerra nga OSBE-ja, dhe shoqëria civile për një pjesë të kësaj zone janë paraqitur më poshtë.

Tabela 9. Të dhënat për komunën e Leposaviqit¹⁸

Numri i përafërt i pjesëtarëve të komuniteteve								
Viti	Shqiptarë	Serbë	Romë	Ashkali	Egjiptianë	Boshnjakë	Turq	Të tjerë
2010	400	15.500	150			450		

Tabela 10. Të dhënat për komunën e Zubin Potokut¹⁹

Përqindja e popullsisë								
Viti	Shqiptarë	Serbë	Romë	Ashkali	Egjiptianë	Boshnjakë	Turq	Të tjerë
1991*	46,40%	52,60%		-		-	-	1,00%
2008	11,6	89,4		-		-	-	-
2009 *	5,4%	93,9%						manje od 1%

¹⁵ Vlerësim i ESJ: regjistrimi '91 Popullsia, buletini nr. 9 Beograd 1995 (për shqiptarët është vlerësim derisa, serbët janë regjistruar)

¹⁶ <http://www.leposavic.org/Opste-Infomacije/> html: <http://www.opstinazvecan.rs/index>.

¹⁷ MUNICIPAL PROFILES November 2011, OSBE, Mission in Kosovo – Burim i bazuar n administratat komunale të këtyre komunave

¹⁸ <http://www.ecmikosovo.org/>

¹⁹ Po aty

Tabela 11. Të dhënat për komunën e Zveçanit²⁰

Përqindja e popullsisë								
Viti	Shqiptarë	Serbë	Romë	Ashkali	Egjiptianë	Boshnjakë	Turq	Të tjerë
1991*	16,20%	79,10%	0,10%			0,80%	0,20%	3,60%
2008	4,50%	95%	0,10%	0,10%		0,30%		
2010	5,80%	94%	0,10%	0,10%				

Për shkak të mos pjesëmarrjes së kësaj zone, në Regjistrimin e Popullsisë, të realizuar në muajin prill 2011, bazuar në analizat, faktet demografike dhe trendët e lëvizjeve të popullsisë, mund nxirret përfundimi se të dhënat e vlerësuara për komunitetin serb nga përfaqësuesit komunalë të komunave: Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe pjesës veriore të Mitrovicës nuk paraqesin të dhëna reprezentative.

Këto vlerësime janë shfrytëzuar nga ana e komunave deri me tani edhe nga institucionet e ndryshme, duke përfshirë ato ndërkombëtare.

Për shkak të këtyre dallimeve në numrin e popullsisë të komuniteti serb, bazuar në burimet, faktet dhe trendët demografikë, me poshtë është bërë një analizë me fokus komunitetin serb.

Të dhënat demografike

Të dhënat statistikore tregojnë se komuniteti serb në dekadat e fundit ka pasur një tendencë të zvogëlimit të popullsisë, si pasojë e shtimit të vogël natyror, si dhe lëvizjeve mekanike të popullsisë.

Tabela 12. Shtimi natyror të komuniteti serb i Kosovës për periudhën 1986-1996²¹

Vitet	1986	1987	1988	1989	1990	1991	1992	1993	1994	1995	1996
Shtimi natyror	2.051	2.069	1.846	1.588	2.021	2.044	1.620	1.632	1.610	855	959

Një trend i tillë i rënies së numrit të popullsisë serbe është edhe në viset e tjera ku banon popullsia serbe si në Kosovë ashtu edhe jashtë saj.

²⁰ Po aty

²¹ Popullsia, ekonomitë familjare sipas vendbanimeve dhe organizimi territorial i Kosovës deri në vitin 2008, Prishtinë ESK

KAPITULLI 2

Tabela 13. Rritja natyrore e popullsisë në Serbi²²

Vitet	Të lindurit të gjallë	Të lindurit të gjallë në 1000 banorë	Numri i të vdekurve	Numri i të vdekurve në 1000 banorë	Rritja natyrore	Rritja natyrore në 1000 banorë
1999	72.222	9,6	101.444	13,5	-29.222	-3,9
2000	73.764	9,8	104.042	13,8	-30.278	-4,0
2001	78.435	10,5	99.008	13,2	-20.573	-2,7
2002	78.101	10,4	102.785	13,7	-24.684	-3,3
2003	79.025	10,6	103.946	13,9	-24.921	-3,3
2004	78.186	10,5	104.320	14,0	-26.134	-3,5
2005	72.180	9,7	106.771	14,3	-34.591	-4,6
2006	70.997	9,6	102.884	13,9	-31.887	-4,3
2007	68.102	9,2	102.805	13,9	-34.703	-4,7
2008	69.083	9,4	102.711	14,0	-33.628	-4,6
2009	70.299	9,6	104.000	14,2	-33.701	-4,6
2010	68.304	9,4	103.211	14,2	-34.907	-4,8
2011	65.598	9,0	102.935	14,2	-37.337	-5,2

Të dhënat nga regjistrimet e popullsisë 1948-1991

Të dhënat për komunitetin serb tregojnë se pjesëmarrjen më të madhe në popullsinë e përgjithshme të Kosovës e kishte në vitet '50-të me 24.1 % në nivel vendi. Që nga ajo kohë, komuniteti serb i Kosovës ka pasur rënie të vazhdueshme.

Tabela 14. Të dhënat nga regjistrimet e popullsisë 1948-1991 për komunitetin serb në Kosovë²³

Te dhënat:	1948	1953	1961	1971	1981	1991
Komuniteti serb	176.718	189.869	227.016	228.264	209.497	194.190
% në nivel të Kosovës	24,1	23,3	23,5	18,4	13,2	9,9

Të dhënat për periudhën 1981-1991 tregojnë se komuniteti serb në këto komuna (*Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan*) kishte një zvogëlim prej -7.0% apo gjithsej -2.116 banorë. Ndërsa, komuniteti shqiptar kishte një rritje prej 84.3% apo 2.271 banorë, si dhe komunitetet e tjera kishin një rritje prej 3.0% apo 52 banorë.

²² <http://webrzs.stat.gov.rs/WebSite/>

²³ Burimi: Publikimet nga Regjistrimet e popullsisë 1948-1991

Tabela 15, Numri i popullsisë sipas etnicitetit 1981-1991 si dhe rritja/zvogëlimi i popullsisë

Vitet	Gjithsej	Shqiptarë	Serbë	Të tjerë
		Numri i popullsisë		
1981 ²⁴	34.697	2.693	30.288	1.716
1991 ²⁵	34.904	4.964	28.172	1.768
Rritja/zvogëlimi në %	0,6	84,3	(7,0)	3,0

Tabela 16. Numri i popullsisë sipas regjistrimeve 1948-1991 (për periudhën 1981-1991 sipas etnicitetit)

Vitet	Leposaviqi			Zveçani			Zubin Potoku			Gjithsej komunitete			Ukupno u ovim opštinama			
	Gjithsej	Shqiptarë	Serbë	Të tjerë	Gjithsej	Shqiptarë	Serbë	Të tjerë	Gjithsej	Shqiptarë	Serbë	Të tjerë				
		Numri i popullsisë				Numri i popullsisë				Numri i popullsisë						
'48	14.851				6.417				9.502				30.770			
'53	16.911				7.890				10.403				35.204			
'61	18.910				9.166				10.642				38.718			
'71	18.044				1.095				9.516				37.655			
'81	16.906	858	14.977	1.071	9.710	1.044	8.115	551	8.081	791	7.196	94	2.693	30.288	1.716	34.697
'91	16.395	951	14.299	1.145	10.030	1.934	7.591	505	8.479	2.079	6.282	118	4.964	28.172	1.768	34.904

Zhvendosjet e popullsisë

Për shkak të rrethanave (lufta 1998-1999) në këtë zonë ka pasur lëvizje të popullsisë, ku një pjesë e komunitetit shqiptar është zhvendosur në vendet e tjera të Kosovës (*jashtë këtyre komunave*). Ndërsa, një pjesë tjetër e komunitetit serb nga komunat e tjera të Kosovës është vendosur në këto komuna.

Siç u cek më lartë, nga të gjitha burimet e marra, si dhe duke u bazuar në azhurnimin e vitit 2009, numri i popullsisë shqiptare në këto tri komuna (pa përfshirë pjesën veriore të Mitrovicës) ishte gjithsej 1.704 banorë.

²⁴ Regjistrimi 1981: Popullsia sipas kombësisë dhe vendbanimeve në KSA të Kosovës. Rezultatet përfundimtare faza e parë, buletini 33, qershor 1984 Prishtinë

²⁵ Regjistrimi 1991, Burimi: Savezni zavod za statistiku Beograd, buletini nr. 17/97 Beograd/Procena za Kosovo I Metohiju, podaci po naseljima I opstinama

KAPITULLI 2

Sipas të dhënave të fundit të muajit shtator 2012 nga UNHCR²⁶, numri i personave nga komuniteti shqiptar, që janë zhvendosur kryesisht në Mitrovicën e Jugut me origjinë nga pjesa veriore e qytetit të Mitrovicës, Zveçanit, Leposaviqit dhe Zubin Potokut ishte gjithsej 7.260 persona të zhvendosur.

Po ashtu, një pjesë e komunitetit serb, të zhvendosur, me origjinë nga vendbanimet/komunat e tjera të Kosovës u vendos në këto komuna: Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan, duke përfshirë edhe pjesën veriore të Mitrovicës, që ishin rreth 6,950 persona të zhvendosur.

Në tabelën e mëposhtme, të dhënat për vitet 2001, 2009 dhe 2011 janë llogaritur në bazë të mesatares së lëvizjes së popullsisë gjatë viteve 1981-1991.

Tabela 17. Të dhënat nga regjistrimet e popullsisë dhe llogaritjet

Viti	Leposaviq				Zveçan				Zubin Potok				Gjithsej
	Gjithsej	Shqiptarë	Serbë	Të tjerë	Gjithsej	Shqiptarë	Serbë	Të tjerë	Gjithsej	Shqiptarë	Serbë	Të tjerë	
1981	16.906	858	14.977	1.071	9.710	1.044	8.115	551	8.081	791	7.196	94	34.697
1991	16.395	951	14.299	1.145	10.030	1.934	7.591	505	8.479	2.079	6.282	118	34.904
2001²⁷	15.884	1.044	13.621	1.219	10.350	2.824	7.067	459	8.877	3.367	5.368	142	35.111
UNHCR²⁸	1.332	(721) ²⁹	1.930	123	(1.198)	(2.438)	1.189	51	(814)	(2.371)	1.557		-680
2009	17.216	323	15.551	1.342	9.152	386	8.256	510	8.063	996	6.925	142	34.431
2011	17.209	340	15.436	1.433	9.020	388	8.177	455	8.059	1.000	6.887	172	34.288

Në bazë të llogaritjeve të bëra, numri i popullsisë në këto tri komuna është 34,288 banorë, ndërsa në bazë të azhurnimit 2009 këto komuna kishin gjithsej 27.870 banorë.

Nëse do të merrreshin në konsideratë faktorët e tjerë, si: rënia e shtimit natyror të të gjitha komunitetave, duke filluar nga vitet '90-të, si dhe shpërnguljet e popullsisë për shkaqe të ndryshme në vendet e tjera jashtë Kosovës, atëherë popullsia e këtyre komunave do të ishte shumë e përafërt me numrin e evidentuar gjatë azhurnimit 2009³⁰.

²⁶ UNHCR, Office of the Chief of Mission Pristina, Kosovo; STATISTICAL OVERVIEW, Update at end September 2012, faqe 4, bazuar në anketën e vitit 2005/2006.

²⁷ Te llogaritura sipas trendëve demografike 1981-1991

²⁸ UNHCR, Office of the Chief of Mission Pristina, Kosovo; STATISTICAL OVERVIEW, Update at end September 2012, faqe 4, bazuar në anketën e vitit 2005/2006.

²⁹ Të dhënat mbi numrin e të zhvendosurve për popullsinë shqiptare janë të vlerësuara, bazuar në trendët demografike 1981-1991

³⁰ Për më shumë shih raportet e ASK-së gjatë viteve 1991-2011

Derisa të dhënat e dala nga azhurnimi i vitit 2009 tregonin një përputhshmëri me të dhënat e dala nga Regjistrimi i Popullsisë i muajit prill 2011 për shumë indikatorë si:

- numrin e popullsisë në 34 komuna: azhurnimi 2009-Regjistrimi i Popullsisë 2011 (dallimi 1.5%)
- numrin mesatar të anëtarëve në një ekonomi familjare në 34 komuna: azhurnimi 2009-Regjistrimi i Popullsisë 2011 (dallimi 0.4%)
- numrin mesatar të anëtarëve në një ekonomi familjare te komuniteti serb: azhurnimi 2009-Regjistrimi i Popullsisë 2011 (dallimi 0.2%)
- numrin e popullsisë shqiptare në komunat: Leposaviqi, Zubin Potok dhe Zveçan: azhurnimi 2009-Regjistrimi i Popullsisë 2011 (dallimi 0.2%).

Bazuar se të dhënat nga azhurnimi 2009 kishin burim ekonomitë familjare, të dhënat korrespondonin me të dhënat e dala nga Regjistrimi i Popullsisë 2011 dhe burimet e tjera si këto dy aktivitete ishin realizuar brenda një periudhe kohore prej më pak se dy vjet, të dhënat e azhurnimit 2009 do të merren si të dhëna zyrtare për numrin e popullsisë së kësaj zone.

KAPITULLI 3

Lëvizjet e popullsisë 01 prill - 31 dhjetor 2011

Shtimi natyror

Të dhënat administrative thelbësore (lindjet e gjalla, vdekjet) kanë një nivel të lartë besueshmërie, që arrin në nivelin pothuaj reprezentativ të gjendjes në terren, përveç rasteve të lindjeve, që nuk raportohen nga komuniteti serb. Ky komunitet i raporton kryesisht një pjesë të rasteve të vdekjeve³¹.

Shënim: Në vlerësimin e të dhënave thelbësore mbi natalitetin dhe mortalitetin te komuniteti serb i Kosovës, si burim janë marrë të dhënat mesatare të natalitetit dhe mortalitetit në Serbi.

Kualiteti i të dhënave

Për ta vlerësuar kualitetin e të dhënave thelbësore, ASK-ja ka krahasuar këto të dhëna me të dhënat e fundit, të dala nga Regjistrimi i Popullsisë 2011.

Pasi ka qenë e mundur, që nga Regjistrimi i Popullsisë të nxirren indikatorët mbi lindjet e gjalla, për një periudhë kohore prej gjashtë (6) vjetësh, si dhe vdekjet e foshnjave³², ato janë krahasuar me të dhënat e grumbulluara në formë administrative për këta indikatorë.

Të dhënat e grumbulluara në formë administrative tregojnë se gjatë periudhës 2006-2010 janë regjistruar si lindje të gjalla 143,864 raste, derisa gjatë Regjistrimit të Popullsisë, për këtë periudhë, janë regjistruar 149,735 raste.

Tabela 18. Krahasimi i dy burimeve të të dhënave mbi lindjet e gjalla

Të dhënat nga:	Vdekjet e foshnjave
Regjistrat e lindjeve (2006-2010)	143.864
Regjistrimi i Popullsisë 2011	149.735

Ky ndryshim i numrit të lindjeve ndërmjet të dhënave administrative dhe Regjistrimit të Popullsisë së vitit 2011 është si pasojë e mosraportimit të të gjitha rasteve të lindjeve, e sidomos nga komuniteti serb (të regjistruarit në gjendjen civile), ndonëse në Regjistrimin e Popullsisë ata ishin pjesëmarrës.

³¹ <http://esk.rks-gov.net/publikimet/popullsia> : Në vitin 2009 komuniteti serb ka raportuar gjithsej 113 raste të vdekjeve, 2010 gjithsej 95 dhe në vitin 2011 gjithsej 140 raste të vdekjeve.

³² Pyetësori R3 pyetja nr. 7: A KENI LINDUR FËMIJË TË GJALLË PAS VITIT 2005/ Nëse po, shkruaj numrin e fëmijëve të lindur të gjallë pas vitit 2005 si dhe pyetja nr.8 A KA PREJ FËMIJËVE TË LINDUR TË GJALLË PAS VITIT 2005 QË JU KANË VDEKUR NËN MOSHËN 1 VJEQARE/ nëse po, shkruaj numrin e fëmijëve të vdekur

Ndërsa, vdekjet e foshnjave, pothuajse plotësisht janë në linjë të njëjtë nëse krahasohen të dhënat administrative dhe të dhënave nga Regjistrimi i Popullsisë 2011.

Ky ndryshim krejtësisht i vogël është rrjedhojë e asaj se komuniteti serb nuk i ka raportuar të gjitha rastet e vdekjeve në regjistrin civil të Kosovës (rastet e vdekjeve të foshnjave), ndërsa ata kanë marrë pjesë në Regjistrimin e Popullsisë.

Tabela 19. Krahasimi i dy burimeve të të dhënave

Të dhënat nga:	Vdekjet e foshnjave
Regjistrat e lindjeve (2006-2010)	335
Regjistrimi i Popullsisë 2011	329

Bazuar në këto të dhëna, mund të konkludojmë se rastet e lindjeve dhe vdekjeve të foshnjave nga të dhënat administrative, ashtu edhe ato nga Regjistrimi i Popullsisë paraqesin përputhshmëri dhe të dhëna të besueshme statistikore.

Të dhënat për numrin e rasteve të vdekjeve nuk ka qenë e mundur të krahasohen pasi nuk ka pasur pyetje të këtillë në formularin e Regjistrimit të Popullsisë 2011.

Në tabelën e mëposhtme janë dhënë të dhënat e numrit të popullsisë në nivel të komunave sipas Regjistrimit të Popullsisë 2011 dhe ngjarjet thelbësore (*lindjet e gjalla dhe vdekjet*) që kanë ndodhë nga data 01 prill deri më 31 dhjetor 2011.

KAPITULLI 3

Tabela 20. Regjistrimi i Popullsisë 2011/shtimi natyror për periudhën 01 prill–31 dhjetor 2011

Komuna	Periudha referuese				
	Regjistrimi i Popullsisë 2011	01 prill-31 dhjetor 2011			Regjistrimi+ shtimi natyror
		Nataliteti	Mortaliteti	Shtimi natyror	
Deçan	40,019	562	113	449	40,468
Gjakovë	94,556	1,327	335	992	95,548
Glllogoc	58,531	983	167	816	59,347
Gjilan	90,178	1,165	335	831	91,009
Dragash	33,997	583	156	427	34,424
Istog	39,289	541	132	409	39,698
Kaçanik	33,409	500	122	378	33,787
Klinë	38,496	740	120	620	39,116
Fushë Kosovë	34,827	573	123	450	35,277
Kamenicë	36,085	349	150	199	36,284
Mitrovicë	84,235	1,243	356	887	85,122
Leposaviq	13,773	92	130	-38	13,735
Lipjan	57,605	951	164	787	58,392
Novobërdë	6,729	45	30	15	6,744
Obiliq	21,549	315	66	249	21,798
Rahovec	56,208	1,014	151	862	57,070
Pejë	96,450	1,351	320	1,031	97,481
Podujevë	88,499	1,251	236	1,015	89,514
Prishtinë	198,897	2,922	605	2,317	201,214
Prizren	177,781	2,640	552	2,087	179,868
Skënderaj	50,858	848	131	718	51,576
Shtime	27,324	426	58	369	27,693
Shtërpçë	6,949	74	46	28	6,977
Suharekë	59,722	1,165	214	951	60,673
Ferizaj	108,610	1,636	361	1,275	109,885
Viti	46,987	700	161	539	47,526
Vushtrri	69,870	1,033	233	800	70,670
Zubin Potok	6,616	52	58	-6	6,610
Zveçan	7,481	54	76	-23	7,458
Malishevë	54,613	1,149	118	1,031	55,644
Junik	6,084	71	12	59	6,143
Mamushë	5,507	92	10	82	5,589
Hani i Elezit	9,403	145	25	120	9,523
Graçanicë	10,675	63	67	-4	10,671
Ranillug	3,866	25	37	-12	3,854
Partesh	1,787	21	23	-2	1,785
Klllokot	2,556	17	19	-2	2,554
Gjithsej	1,780,021	26,719	6,014	20,705	1,800,726

Lëvizjet e tjera të popullsisë (migrimet)

Emigrimi dhe imigrimi³³

Kosova ka miratuar Ligjin "Për vendbanimin dhe vendqëndrimin"³⁴ (nr. 02/L-121) në shtator të vitit 2007. Por, zbatimi i tij në praktikë është në fazat e para, dhe njëkohësisht, është sfidë që duhet adresuar dhe zbatuar nga organet përgjegjëse.

Zbatimi i këtij ligji, duke përfshirë: qytetarët, qiradhënësit, zyrat e gjendjes civile dhe institucionet e tjera kompetente, do të ishte i një dobie të veçantë për gjithë shoqërinë kosovare.

Krijimi i një baze të të dhënave mbi lëvizjet e popullsisë, si dhe monitorimi i vazhdueshëm, do t'u mundësonte institucioneve, kryesisht komunave të bëjnë plane dhe strategji të mirëfillta për komunën e tyre, bazuar në këto të dhëna.

Me këtë ligj, obligohen të gjithë qytetarët, që ndërrojnë vendbanimin apo adresën e banimit, që brenda afatit prej 8 (tetë) ditësh, t'i paraqesin tek organet kompetente, informatat themelore për familjen dhe disa të dhëna të tjera personale, ashtu siç janë specifikuar në këtë ligj (*plotësimi i formularit të çlajmërimit -lajmërimit*).

Po ashtu, të gjithë qytetarët që largohen për më shumë se tre muaj nga Kosova, bazuar në këtë ligj, kanë si obligim, ta lajmërojnë organin kompetent para se të udhëtojnë. Qytetarët që kthehen dhe që kanë për qëllim banimi të përhershëm, duhet që brenda 8 (tetë) ditësh, pas kthimit, ta lajmërojnë organin kompetent për kthimin e tij/saj.

Ndonëse janë paraparë dispozita ndëshkuese ato shumë pak gjejnë zbatim në praktikë.

Prandaj, në mungesë e këtyre të dhënave, për ndryshimet demografike, që kanë ndodhur pas Regjistrimit të Popullsisë (momentit kyç - 31 mars 2011 ora 24.00) ASK-ja është mbështetur në burimet alternative, duke aplikuar metoda dhe standarde statistikore për vlerësim.

³³ **Emigrimi** - paraqet shkuarjen e popullsisë nga një vend i caktuar. Imigrimi- ardhja e popullsisë në një vend të caktuar.

³⁴ <http://www.assembly-kosova.org>

Emigrimi dhe imigrimi i brendshëm

Si burim i të dhënave mbi lëvizjet e popullsisë brenda Kosovës janë marrë të dhënat nga:

- Baza e të dhënave e Regjistrimit të Popullsisë 2011
- Ministria e Punëve të Brendshme
- Ministria e Kthimit
- Ministria e Pushteti Lokal dhe
- Komunat

Të dhënat nga Ministrinë nuk pasqyrojnë gjendjen në terren, rreth lëvizjeve të brendshme të popullsisë. Një kontribut të çmuar mbi lëvizjet e brendshme kanë dhënë komunat, ku ASK-ja iu kishte kërkuar të dhëna për numrin e ekonomive familjare dhe personave sipas etnicitetit, që kanë ardhur respektivisht janë larguar nga komunat e tyre (brenda Kosovës), për më shumë se një vit, duke respektuar ligjet në fuqi.

Vetëm 1/4 e komunave kishin raportuar disa të dhëna, kryesisht për personat që janë vendosur në komunat e tyre. Ndërsa, për personat që janë larguar, vetëm rreth 10% e komunave kishin ofruar të dhëna.

Të dhënat nga burimet e theksuara mbi lëvizjet e popullsisë nga një vendbanim/komunë në tjetrin, pasi janë analizuar, kanë rezultuar se këto të dhëna nga institucionet relevante nuk ishin reprezentative të gjendjes në terren.

Institucionet relevante ofruan një numër krejtësisht të vogël të migrameve të brendshme (gjithsej rreth 1.400 persona), gjë që nuk paraqitë numrin e lëvizjeve reale, bazuar në statistikat që ka ASK-ja.

Prandaj, ASK-ja ka marrë si burim kryesor, për lëvizjet e brendshme, bazën e të dhënave nga Regjistrimi i Popullsisë 2011.

Në tabelën e mëposhtme, të dhënat paraqesin numrin e personave, që kanë ndërruar vendbanimin/komunën e tyre (brenda tri viteve) dhe janë vendosur në një vendbanim/komunë tjetër, në Kosovë për arsye të ndryshme si: punësimi, arsye familjare (bashkim me familjen, martesat), shpërnguljet e përhershme, si dhe faktorët e tjerë socio-ekonomikë.

Kjo bazë e të dhënave është një pasqyrë se si kanë ndodhur migrimet e brendshme brenda periudhës 01 prill - 31 mars 2008-2011.

Në bazë të kësaj, trendi i lëvizjeve nga viti në vit është pothuaj i përafërt për këto tri vjet. Prandaj, si bazë për migrimet e brendshme është marrë mesatarja e këtyre tri viteve, brenda nëntë (9) muajve. Këtyre lëvizje (01 prill -31 dhjetor 2011) iu kanë shtuar numrit gjithsej të komunave përkatëse.

Tabela 21. Migrimi i brendshëm në Kosovë

KOMUNA	Data e lëvizjes nga vendbanimi i mëparshëm										
	01 prill 2008-31 mars 2009		1 prill 2009-31 mars 2010		1 prill 2010-31 mars 2011		Gjithsej		Balanci i migrimit të brendshëm (3 viteve)	Mesatarja vjetore	Mesatarja për 9 muaj
	Ardhur	Larguar	Ardhur	Larguar	Ardhur	Larguar	Ardhur	Larguar			
Deçan	123	151	115	171	143	174	381	496	-115	-38	-29
Gjakovë	200	349	293	409	316	346	809	1,104	-295	-98	-74
Glllogoc	230	400	240	409	251	387	721	1,195	-474	-158	-119
Gjilan	331	381	335	453	426	424	1,092	1,258	-166	-55	-41
Dragash	50	99	40	165	73	202	163	466	-303	-101	-76
Istog	228	117	262	132	227	167	717	416	301	100	75
Kaçanik	115	195	129	214	96	267	340	676	-336	-112	-84
Klinë	196	229	206	273	269	266	671	767	-96	-32	-24
Fushë Kosovë	675	146	922	190	972	247	2,569	582	1,987	662	497
Kamenicë	67	419	96	432	106	461	269	1,312	-1,043	-348	-261
Mitrovicë	213	320	281	404	342	414	836	1,138	-302	-101	-75
Leposaviq	0	9	0	12	0	5	0	26	-26	-9	-7
Lipjan	236	267	294	333	296	360	826	960	-134	-45	-33
Novobërdë	117	47	151	40	81	22	349	109	240	80	60
Obiliq	182	196	183	162	205	226	570	584	-14	-5	-4
Rahovec	121	203	159	326	220	258	500	787	-287	-96	-72
Pejë	273	311	325	286	297	331	895	928	-33	-11	-8
Podujevë	132	724	190	938	173	971	495	2,633	-2,138	-713	-534
Prishtinë	2,104	1,015	2,619	1,404	2,544	1,554	7,267	3,973	3,294	1,098	823
Prizren	523	342	671	392	793	415	1,987	1,149	838	279	209
Skënderaj	172	499	196	548	216	583	584	1,630	-1,046	-349	-262
Shtime	137	191	152	158	167	171	456	520	-64	-21	-16
Shtërpçë	22	75	29	38	19	63	70	177	-107	-36	-27
Suharekë	172	224	209	233	222	361	603	818	-215	-72	-54
Ferizaj	506	266	485	395	595	362	1,586	1,023	563	188	141
Viti	132	180	177	278	161	264	470	722	-252	-84	-63
Vushtrri	229	303	270	408	294	455	793	1,165	-372	-124	-93
Zubin Potok	0	4	0	6	0	3	0	14	-14	-5	-3
Zveçan	0	7	0	8	0	9	0	25	-25	-8	-6
Malishevë	213	281	226	390	197	407	636	1,078	-442	-147	-110
Junik	34	13	43	16	33	22	110	51	59	20	15
Mamushë	0	0	5	0	4	4	9	4	5	2	1
Hani i Elezit	51	46	39	46	53	42	143	135	8	3	2
Graçanicë	218	10	259	11	409	18	886	39	847	282	212
Ranillug	4	3	12	4	12	4	28	12	16	5	4
Partesh	3	3	7	6	7	2	17	12	5	2	1
Klllokot	19	0	75	6	50	1	144	7	137	46	34
Gjithsej	8,028	8,028	9,695	9,695	10,269	10,269	27,992	27,992	0	0	0

KAPITULLI 3

Emigrimi dhe imigrimi i jashtëm

Si burim i të dhënave për emigrimin dhe imigrimin e jashtëm janë shfrytëzuar këto të dhëna:

- Baza e të dhënave të Regjistrimit të Popullsisë 2011
- EUROSTAT-i
- Ministria e Punëve të Brendshme
- Komunat
- Ministria e Kthimit
- Ministria e Pushteti Lokal

Emigrimi i jashtëm

Siç u theksua më lartë, qytetarët të cilët largohen nga Kosova nuk raportojnë pothuaj në asnjë institucion përkatës mbi destinacionin, kohën e largimit, apo qëllimin e largimit. Institucionet përkatëse nuk kanë shënime bazë, të plota, mbi numrin e personave që emigrojnë.

Raportet e ndryshme të vendeve, që pranojnë emigrantë, tregojnë se kosovarët janë orientuar të emigrojnë kryesisht në vendet e Bashkimit Evropian.

Po ashtu, një pjesë e vogël e emigrantëve, përveç në vendet e BE-së, janë orientuar edhe në kontinentet e tjera si: Amerikë (*sidomos në SHBA dhe Kanada*), Azi (*Afganistan, Irak dhe vende të tjera*), Australi (*Australi, Zelandë e Re*) dhe Afrikë (*vende të ndryshme*).

Ndërsa, sa i përket të dhënave mbi numrin e kosovarëve, që hyjnë në BE (Evropë), çdo vit, shtetet e BE-së raportojnë në EUROSTAT, për personat që emigrojnë në kontinentet e tjera. Por, nuk ka të dhëna nga ndonjë burim në dispozicion.

Si burim kryesor për vlerësimin e emigrimit të kosovarëve në vendet e Bashkimit Evropian janë marrë të dhënat zyrtare nga EUROSTAT-i për periudhën 2009/ 2010, 2010/ 2011 dhe 2011/2012.

Tabela 22. Numri i shtetasve kosovarë që kanë kërkuar azil në vendet e BE-së³⁵

	Periudha kohore												Gjithsej
	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	
2009/2010	1.570	1.375	1.210	885	1.065	1.270	1.110	945	985	960	1.190	1.370	13.935
2010/2011	1.545	1.610	1.355	1.000	1.000	1.095	1.020	900	615	545	670	730	12.085
2011/2012	695	725	795	670	560	740	505	720	790	815	755	930	8.700

Sipas të dhënave, numri i kosovarëve që kanë kërkuar azil gjatë periudhës nëntë (9) mujore (01 prill - 31 dhjetor 2011) në vendet e BE-së është gjithsej 6.695 persona. Ky numër i emigrimit do të merret si bazë e bilancit të emigrimit, që është shpërndarë në mënyrë proporcionale me numrin e popullsisë nëpër komuna.

Imigrimi i jashtëm

Institucionet relevante vendore dhe ndërkombëtare nuk kanë mbuluar të gjithë personat që imigronin në Kosovë. Për shkak të profilit³⁶ të ndryshëm të personave që imigronin në Kosovë, vetëm për një grup të caktuar, disa institucione, kishin të dhëna bazuar në metodologjitë që aplikojnë ato institucione.

Të dhënat e marra nga: ministritë, komunat dhe institucionet e tjera vendore, pasqyronin një numër të vogël të të kthyerve. Ndërsa, të dhënat UNHCR dhe IMO pasqyronin një numër më të madh të të kthyerve.

Në tabelën e mëposhtme është dhënë numri i përgjithshëm i personave të kthyer në Kosovë të të gjitha komuniteteve nga të gjitha vendet. Kjo tabelë pasqyron personat e kthyer (në mënyrë vullnetare, të detyruar dhe të asistuar nga IOM) me origjinë nga Kosova, duke përfshirë: *personat e kthyer nga vendet e ndryshme, të zhvendosurit, si dhe refugjatët.*

³⁵ EUROSTAT

³⁶ a. Të kthyerit nga vendet tjera, b. Të zhvendosurit (personat e asistuar, vullnetar, të detyruar) c. Personat që kanë imigruar pas shumë viteve në Kosovë (shtetas apo jo shtetas të Kosovës) ç. Martesat e ndryshme me shtetas jashtë Kosovës d. Personat që kanë imigruar për shkaqe të aktiviteteve si: biznese, punë, organizata etj.

KAPITULLI 3

Tabela 23. Të dhënat mbi numrin e personave të kthyer në Kosovë 2010-2012

Institucionet	Personat: të kthyer, të zhvendosur dhe refugjatët		
	2010	2011	2012
UNHCR ³⁷	8.507	6.152	3.796 ³⁸
IOM ³⁹	2.204	1.789	1.306

Duke qenë se të dhënat nga UNHCR janë burime reprezentative dhe të besueshme, këto të dhëna janë marrë si bazë për numrin e personave që kanë imigruar në Kosovë.³⁷³⁸³⁹

Meqenëse të dhënat përfshijnë periudhën një (1) vjeçare, numri mesatar i të kthyerve brenda nëntë (9) muajve ishte rreth 4.614 persona.

Bilanci i migrimit të jashtëm, sipas këtyre të dhënave në Kosovë, për periudhën 01 prill - 31 dhjetor 2011 në nivel vendi ishte **-2.081 persona**.

³⁷ UNHCR, Office of the Chief of Mission Pristina, Kosovo, STATISTICAL OVERVIEW, Update at end September 2012

³⁸ Deri në muajin shtator 2012

³⁹ International Organization for Migration, mission in Kosovo

Tabela 24. Të dhënat përfundimtare të vlerësuara për vitin 2011 sipas komunave

Komunat	Të dhënat nga:				Gjithsej popullsia e vlerësuar (31 dhjetor 2011)
	Regjistrimi i Popullsisë 2011	Shtimi natyror (01/04-31/12/2011)	Balanci i migrimeve		
			Të jashtme (01/04-31/12/2011)	Të brendshme (01/04-31/12/2011)	
Deçan	40,019	449	-47	-29	40,392
Gjakovë	94,556	992	-111	-74	95,363
Glogoc	58,531	816	-68	-119	59,160
Gjilan	90,178	831	-105	-41	90,863
Dragash	33,997	427	-40	-76	34,308
Istog	39,289	409	-46	75	39,727
Kaçanik	33,409	378	-39	-84	33,664
Klinë	38,496	620	-45	-24	39,047
Fushë Kosovë	34,827	450	-41	497	35,733
Kamenicë	36,085	199	-42	-261	35,981
Mitrovicë	84,235	887	-98	-75	84,949
Leposaviq	13,773	-38	-16	-7	13,712
Lipjan	57,605	787	-67	-33	58,292
Novobërdë	6,729	15	-8	60	6,796
Obiliq	21,549	249	-25	-4	21,769
Rahovec	56,208	862	-66	-72	56,932
Pejë	96,450	1,031	-113	-8	97,360
Podujevë	88,499	1,015	-103	-534	88,877
Prishtinë	198,897	2,317	-233	823	201,804
Prizren	177,781	2,087	-208	209	179,869
Skënderaj	50,858	718	-59	-262	51,255
Shtime	27,324	369	-32	-16	27,645
Shtërpcë	6,949	28	-8	-27	6,942
Suharekë	59,722	951	-70	-54	60,549
Ferizaj	108,610	1,275	-127	141	109,899
Viti	46,987	539	-55	-63	47,408
Vushtrri	69,870	800	-82	-93	70,495
Zubin Potok	6,616	-6	-8	-3	6,599
Zveçan	7,481	-23	-9	-6	7,443
Malishevë	54,613	1,031	-64	-110	55,470
Junik	6,084	59	-7	15	6,151
Mamushë	5,507	82	-6	1	5,584
Hani i Elezit	9,403	120	-11	2	9,514
Graçanicë	10,675	-4	-12	212	10,871
Ranillug	3,866	-12	-5	4	3,853
Partesh	1,787	-2	-2	1	1,784
Klllokot	2,556	-2	-3	34	2,585
Gjithsej	1,780,021	20,705	-2,081	0	1,798,645

